



Pranuar / Dërguar Punë/Prodato Received/Delivered	05.08.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednitsa Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/HA	4575/2022		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.561/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malësore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.561/2022 të datës 23.06.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në Komunën e Malishevës, kundër organit të punësimit Komuna e Malishevës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 05.08.2022, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *Shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.561/2022 të datës 23.06.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 23.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3662/22 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër protokollit 01/660 të datës 27.04.2022 të Kryetarit të Komunës së Malishevës për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës së rekrutimit, shkeljeve të legjislacionit në fuqi, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të miratimit në heshtje të ankesës nr.01/741 të datës 12.05.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.07.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Malishevës. Ndërsa Këshilli, me datë 05.07.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 3662/2022 të datës 23.06.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Dokumentin e identifikimit të


ankuesit; Kërkesën me numër 01/962 të datës 20.06.2022; Kërkesën me numër 11/1289 të datës 20.06.2022; Ankesën me numër 01/741 të datës 12-05/2022; Kërkesën me numër protokoll 06/06 të datës 04.05.2022; Listën e datës 07.04.2022 të kandidatëve që kanë konkuruar për drejtor ose zëvendësdrejtor të institucionit publike edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar; Formularin B/1 të datës 07.04.2022- tabela e vlerësimit të dëshmimeve të prezantuara nga kandidatja kandidati Formularin B/1 të datës 07.04.2022- tabela e vlerësimit të dëshmimeve të prezantuara nga kandidati Formularin "C" i datës 22.04.2022 / "Protokolli i intervistimit të kandidatit Formularin "C" i datës 22.04.2022 - protokolli i intervistimit nga anëtari Formularin "C" i datës 22.04.2022-protokolli i intervistimit nga anëtari Formulari "F" i datës 22.04.2022 i anëtarëve vëzhgues në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për drejtor/ dhe zëvendësdrejtorët të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar me vëzhguese Formularin "F" i datës 22.04.2022 i anëtarëve vëzhgues në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për drejtor/ dhe zëvendësdrejtorët të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar nga vëzhguesi Formularin "E"-Rekomandimi i Komisionit për zgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues; Formularin "D" i datës 22.04.2022-Rangimi i kandidatëve të vlerësuar nga Komisioni Përzgjedhës për SHFMU, "Ganimete Terbeshi" në Astrazup; Vendimin me numër protokoll 01/660 të datës 27.04.2022 për praninë në marrëdhënie punë; Konkursin me numër protokoll 11/81 të datës 28.01.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 01.07.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 3902/2022 të datës 05.07.2022; Letër referencën me numër 11/137 të datës 11.02.2022 të Drejtorisë së Arsimit dhe Edukimit; Kërkesën me numër protokoll 01/237 të datës 18.02.2022 për miratimin e propozimit të Drejtorisë për Arsim dhe Edukim për Komisionin Përzgjedhës; Vendimin me NR.020-225 të datës 07.03.2022 të Kryetarit të Komunës së Malishevës; Përgjigjen me numër të protokollit 477 të datës 15.03.2022 për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të komunës së Malishevës; Vendimin me Nr.02/97 të datës 03.03.2022; Njoftimin me numër 11/614 të datës 13.04.2022 për intervisitimin e kandidatëve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën A.nr.561/2022 të datës 23.05.2022 të parashtruar nga ankuesi

SEPSE:

Nga analizimi i shkresave të lëndës, është konstatuar se ankuesi ka aplikuar në Konkursin e shpallur nga Komuna e Malishevës me numër protokoll 11/81 të datës 28.01.2022, për pozitën e punës " Drejtor në SHFMU "Ganimete Terbeshi" në fshatin Astrazup. I njëjti me datë 23.05.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoll 01/660 të datës 27.04.2022 të Kryetarit të Komunës së Malishevës për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës së rekrutimit, shkeljeve të legjislacionit në fuqi, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të miratimit në heshtje të ankesës nr.01/741 të datës 12.05.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në kuptim të pranushmërisë së ankesës ju referua dispozitave të Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 2 ku përcaktohet se 3. *Nëpunës Civil- është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë,*



duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë. 4. **Nëpunës i Shërbimit Publik** - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se zyrtarët publikë të nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të institucioneve publike të arsimit parauniversitar të Kosovës kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publikë, respektivisht pozita Drejtor i Shkollës nuk hyn në kategorinë e nëpunësve civil, andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet që Këshilli është kompetent të shqyrtoj dhe të vendos vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.561/2022 të datës 23.06.2022 të parashtruar nga ankuesi Rasim Morina.

Kolegji i Këshillit bazuar në dispozitat e nenit 24 dhe nenit 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se zyrtarët publikë me status të nëpunësit të shërbimit publik kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.


Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.561/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Proçesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Malishevës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Malishevës; dhe
- Arkiviot të KPMSHCK-së.

